



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE

DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/ 2020

**Drejtuar: “L.T.E Construction” shpk;**

**Adresa:** Rr. 3 Deshmoret, godine banimi dhe sherbimi 1,2,5,8 dhe 11 kate ne prone te shoqerise Lloxhall, Kashar, Tirane.

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e prokurimit: “Procedure e Hapur”**

**Objekti: “Rehabilitimi i hapësirave publike pranë Mozaikut”**

**Numri i references se procedures/lotit: REF-73542-09-30-2020**

**Fondi limit: 36,839,241** (tridhjetë e gjashtë milion e tetëqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzet e një) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës të VKB Nr. 157 datë 26.12.2019, “Për Miratimin e Programit buxhetor afatmesëm 2020-2022”, dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”.

**Kohëzgjatja e kontratës: 5 (pesë) muaj kalendarike** duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 02.11.2020 Ora: 11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 82 datë 05.10.2020.

#### Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Nika” shpk**

**NUIS J76705047U**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **23,278,424** (njëzetë e tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e njëzetë e katër) lekë.

**2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik "L.T.E Construction" shpk**

**NUIS L78006801F**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **24,070,222** (njëzetë e katër milion e shtatëdhjetë mijë e dyqind e njëzetë e dy) lekë.

**3. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik "Cara" shpk.**

**NUIS K07729920F**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = 24,516,535 (njëzetë e katër milion e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë) lekë.

**4. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik "Eurondërtimi 2000" shpk**

**NUIS K02003001O**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **25,433,515** (njëzetë e pesë milion e katërqind e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë.

**5. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik "Leon Construction" shpk**

**NUIS K71820009I**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **25,752,222.88** (njëzetë e pesë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzetë e dy pikë tetëdhjetë e tetë) lekë.

**6. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik "Euro-Alb" shpk**

**NUIS K66613407H**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **26,454,196.25** (njëzetë e gjashtë milion e katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë njëzetë e pesë) lekë. ëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzetë e dy pikë tetëdhjetë e tetë) lekë.

**7. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik "Beqiri" shpk**

**NUIS J98624801V**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **27,354,460** (njëzetë e shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë.

**8. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik "K. Turja" shpk & "Kegli-Duri" shpk**

**NUIS K81314014A & K94016202U**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **29,193,210** (njëzetë e nëntë milion e njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e dhjetë) lekë.

**9. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik "Arb&Trans-2010" shpk**

**NUIS L02325001T**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **29,573,669.47** (njëzetë e nëntë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë dyzetë e shtatë) lekë.

**10. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk**  
**NUIS K02017003I**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **31,656,045** (tridhjetë e një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyzetë e pesë) lekë.

**11. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “BE-IS” shpk**

**NUIS NUIS K71412003A**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = 33,338,768 (tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

**12. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Agi Kons” shpk**  
**NUIS K21622001M**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **34,641,510** (tridhjetë e katër milion e gjashtëqind e dyzetë e një mijë e pesëqind e dhjetë) lekë.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**  
**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

• **Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Nika” shpk**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **23,278,424** (njëzetë e tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e njëzetë e katër) lekë. Çmimi total i ofertës me tvsh = **27,934,109** (njëzetë e shtatë milion e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë e njëqind e nëntë) lekë.

- Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion vetëm për 1 (një) Automakinist, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6 ku ndër të tjera parashikohet se: “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht ...2 (dy) Automakinist...*”.
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Nika” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton. Pas verifikimeve të dokumentacionit shoqërues, rezulton se për mjetin me targa AA 755 YV nuk është paraqitur Akti i Pronësisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 9, gërma “b”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VII Neni 66 pika 3, e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“L.T.E Construction” shpk me adresë Rr. 3 Deshmoret, godine banimi dhe sherbimi 1,2,5,8 dhe 11 kate ne prone te shoqerise Lloxhall, Kashar,Tirane** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme **24,070,222** (njëzetë e katër milion e shtatëdhjetë mijë e dyqind e njëzetë e dy) lekë është identifikuar si **oferta e suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 24,516,535 (njëzetë e katër milion e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë) lekë siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

### **Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 23.11.2020**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur Formulari i Ankesës në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: “Rehabiliti I hapësirave publike te Mozaikut” nga Operatori Ekonomik “NIKA” shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 42096 Prot. datë 01.12.2020 (administruar në dosjen e prokurimit).

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) me Urdhërin Nr. 32604/3 Prot. dt. 01.12.2020 është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni për prokurimin publik në fuqi. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 32604/2Prot. datë 01.12.2020 u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave, i cili pasi u njoh me pretendimet e Ankimuesit konkludoi në mospranimin e ankesës, duke i kthyer pergjigje Operatorit Ekonomik me shkresën me Nr. 42096/2 Prot, datë 09.12.2020 (administruar në dosjen e prokurimit).